



Në bazë të nenit 50 paragrafi 30 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale ("Fleta zyrtare e MZ" nr. 2/18) dhe nenit 66 paragrafi 2 të Statutit të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz ("Fleta zyrtare MZ- Dispozitat e komunës", nr.39/17) Kryetari i Kuvendit të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz jep

PROPOZIM

Që për ushtrues të detyrës së sekretarit të Kuvendit të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz, emërohet **Nermin Allibashiq**, jurist i diplomuar.

Arsyetim

Me nenin 50 paragrafi 3 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale dhe nenin 66 paragrafi 2 të Statutit të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz është e përcaktuar që sekretarin e kuvendit emëron dhe shkarkon kuvendi, në propozim të kryetarit të kuvendit.

Me nenin 124 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale është e përcaktuar që në rast të pushimit të mandatit kryeadministratorit gjegjësisht personit që kryen punët të kuadrit të lartë udhëheqës, mund të përcaktojë ushtrues detyre deri në emërim, gjegjësisht vendosje në përputhje me këtë ligj dhe më së gjati deri në 6 muaj, ushtruesin e detyrës e përcakton organi kompetent për emërim, gjegjësisht vendosje të personave të cilët kryejnë punët e kuadrit të lartë udhëheqës dhe kryeadministratorit që për ushtrues të detyrës të përcaktohet personi, që plotëson kushtet e përcaktuara për kryeadministrator, gjegjësisht për vend pune të kuadrit të lartë udhëheqës për të cilin përcaktohet, dhe se dispozitat e paragrafit 1 deri në 6 të këtij neni zbatohen në përputhje edhe në përcaktimin e ushtruesit të detyrës dhe kompetencat e tij, si edhe në të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e sekretarit të kuvendit dhe drejtuesve të shërbimeve publike.

Pastaj, me Ligjin mbi vetëqeverisje lokale, nenin 51 paragrafi 1 është e përcaktuar që për sekretar të Kuvendit mund të emërohet personi i cili ka nivelin e kualifikimit VIII të arsimit, fakultetin juridik, të ketë dhënë provimin profesional për punë në organet shtetërore dhe të paktën pesë vjet përvojë pune.

Duke pas parasysh punë e deritanishme dhe angazhimin, si dhe faktin që kandidati i propozuar përmbush të gjitha kushtet e përcaktuara me ligj, kryetari i Kuvendit në kuptimin e nenit 50 paragrafi 3 të Ligjit mbi vetëqeverisje lokale dhe nenit 66 paragrafi 2 të Statutit të komunës në kuadër të Kryeqytetit- Tuz, ka propozuar që për ushtrues të detyrës së sekretarit të Kuvendit të komunës të emërohet Nermin Allibashiq, jurist të diplomuar nga Tuzi. Pjesa përbërëse e arsyetimit është biografia e kandidatit.



Kryetari,
Fadil Kajoshaj